



Banka ProCredit
Shqipëri



Nr. Prot TH2365

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në Tiranë, sot më 23 prill 2012, ndërmjet:

ProCredit Bank sh.a. një shoqëri aksionare e krijuar dhe që ekziston në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër identifikimi (NIPT) J91524011J, me seli në adresën: Rruga "Dritan Hoxha", Tiranë, e përfaqësuar nga dy prej tre administratorëve: Znj. Flutura Veipi, Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive; Znj. Anila Denaj, Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive; Znj. Violeta Haxhillazi, Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive

dhe

Universiteti "Epoka" licensuar me VKM nr. 281, datë 12.03.2008, me adresë në Rr. Tiranë-Rinas, Km.12, Tiranë, pjesë e "Turgut Özal Education" sh.a., e regjistruar pranë organeve tatimore me nr. K12125004O, përfaqësuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Universitetit "Epoka", Prof. Dr. Güngör Turan (në vijim të kësaj kontrate "Universiteti")

Palët, me dëshirën për të zgjeruar marrëdhënien e bashkëpunimit midis dy institucioneve në drejtim të edukimit të studentëve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës dhe shkëmbimit kulturor në fushat e arsimit, kërkimit dhe aktiviteteve të tjera, bien dakord si më poshtë:

1. Objekti dhe Qëllimi

Objekti i kësaj marrëveshje është nxitja e bashkëpunimit mes palëve për programe të ofruara nga secili institucion, të cilët kontribuojnë në drejtim të edukimit të studentëve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës dhe forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese në fusha të tjera me interes të përbashkët.

Çdo program i veçantë bashkëpunimi në kuadër të kësaj marrëveshje do t'i nënshtrohet miratimit të përbashkët, në varësi të fondeve në dispozicion dhe aprovimit të palëve.

Këto programe mund të përfshijnë, gjithnjë me aprovim paraprak, nga palët si më poshtë:

Banka ProCredit sh.a
Rr. Dritan Hoxha
P.O. Box 2395
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355/ 4 2 389 300
Faks: +355/4 233918 / 233880
Info@procreditbank.com.al
www.procreditbank.com.al

Drejtorja Ekzekutive
Anila Denaj, Flutura Veipi, Violeta Haxhillazi
Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive
Flutura Veipi

Vendi i regjistrimit: Tiranë
Nr. Vendimit të Gjykatës: 20797/11.02.1999
KIB: 20911005
Nipt J 91524011J



Banka ProCredit
Shqipëri



Mundësinë e kryerjes së praktikës mësimore me pagesë për studentët e shkëlqyer, pas përzgjedhjes me intervistë.
Informimin dhe ofrimin e mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në pozicionet vakante pranë Bankës.
Organizimi i orëve të hapura nga anëtarë të stafit të Bankës në ambjentet e Universitetit.
Leksione nga anëtarët e stafit të Bankës.
Leksione dhe trajnime nga personeli akademik i Universitetit për stafin e Bankës.
Organizime të aktiviteteve të përbashkëta si konferenca, seminare, forume etj.
Organizimi i eventeve ku biznese që janë klientë të bankës kontaktojnë me studentët.
Vendosja në web-in e Universitetit të njoftimeve dhe posterave që janë në interes të studentëve.

2. Personat e Kontaktit

Personat e kontaktit lidhur me njoftimet të cilat do të kryhen në bazë të kësaj marrëveshje, janë:

Emrat e personit të Kontaktit

a) ProCredit Bank, Shqipëri Përfaqësues të Rekrutimit:

Naida Karagjozi n.karagjozi@procreditbank.com.al / 00355 692097517 dhe
Jonida Pjetërgjokaj j.pjetergjokaj@procreditbank.com.al / 00355 692073452

b) Emri i personit të Kontaktit Universiteti Epoka:

Güngör Turan gturan@epoka.edu.al / 00355 2232 086 Ext: 1600

Banka ProCredit sh.a
Rr. Dritan Hoxha
P.O. Box 2395
Tirane, Shqipëri
Tel: +355/ 4 2 389 300
Faks: +355/4 233918 / 233880
Info@procreditbank.com.al
www.procreditbank.com.al

Drejtoria Ekzekutive
Anila Denaj, Flutura Veipi, Violeta Haxhillazi
Drejtuese e Drejtorise Ekzekutive
Flutura Veipi

Vendi i regjistrimit: Tirane
Nr.Vendimit te Gjykates:20797/11.02.1999
KIB: 20911005
Nipt J 91524011J



Banka ProCredit
Shqipëri



3. Detyrimet e Palëve

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe qëllimeve të kësaj marrëveshje.

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në sigurimin e informacionit, në kufijtë e lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe pa shkelur konfidencialitetin, si dhe asistencën e nevojshme, sipas programit të hartuar dhe miratuar prej tyre në kuadër të kësaj marrëveshje.

Palët rishikojnë bashkarisht programet që do të hartohen në kuadër të marrëveshjes, në mënyrë që të krijojnë mundësitë më të mira për studentët dhe maksimizimin e njohurive të përfituara prej tyre.

Të identifikojnë nevoja të veçanta të cilat mund të përbëjnë bazën e projekteve të bashkëpunimit.

Të mundësojnë vizita reciproke studimore dhe akademike.

Të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme trajnimi me interes të përbashkët për të dyja palët.

Të bëjë të disponueshëm kundrejt kërkesave të arsyetuara dokumentet e punës të konsideruar si jo konfidenciale.

4. Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

5. Përfundimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë, nga secila palë duke njoftuar me shkrim palën tjetër, të paktën 15 ditë përpara.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e një natyre tërësisht rekomanduese dhe nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.

Banka ProCredit sh.a
Rr. Dritan Hoxha
P.O. Box 2395
Tirane, Shqipëri
Tel: +355/ 4 2 389 300
Faks: +355/4 233918 / 233880
Info@procreditbank.com.al
www.procreditbank.com.al

Drejtorja Ekzekutive
Anila Denaj, Flutura Veipi, Violeta Haxhillazi
Drejtuese e Drejtorise Ekzekutive
Flutura Veipi

Vendi i regjistrimit: Tirane
Nr.Vendimit te Gjykates:20797/11.02.1999
KIB: 20911005
Nipt J 91524011J



Banka ProCredit
Shqipëri



EPOKA
UNIVERSITY

PROCREDIT BANK

UNIVERSITETI EPOKA

Flutura Veipi



Dr. Gërgjeth Tërçani



Datë: 24.04.2012

Datë: 24.04.2012

Pasqja, me dashurinë për të zjerrët me ndihën e bashkëpunimit midis dy institucioneve në drejtim të ofrimit të studimeve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës dhe promovimit kulturor në fushat e arsimit, kërkimit dhe aktiviteteve të tjera, blen dakord si më poshtë:

1. Objekti dhe Qllimi

Objekti i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis palëve për programe të bashkëpunimit nga secili institucion, të cilët kontribuojnë në drejtim të ofrimit të studimeve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës dhe forumin e marrëdhënies bashkëpunuese në fushat të tjera me interes të përbashkët.

Kjo program i bashkëpunimit në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të mbështetet financiarisht të përbashkët, në varësi të fondëve në dispozicion dhe aprovimit të palëve.

Keto programe mund të përfshijnë gjithëse me aprovim paraprak, nga palët si më poshtë:

Banka ProCredit sh.a
Rr. Dritan Hoxha
P.O. Box 2395
Tirane, Shqipëri

Tel: +355/ 4 2 389 300
Faks: +355/4 233918 / 233880
Info@procreditbank.com.al
www.procreditbank.com.al

Drejtorja Ekzekutive
Anila Denaj, Flutura Veipi, Violeta Haxhillazi
Drejtuese e Drejtorise Ekzekutive
Flutura Veipi

Vendi i regjistrimit: Tirane
Nr.Vendimit te Gjykates:20797/11.02.1999
KIB: 20911005
Nipt J 91524011J